

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga FONDACIONI VALEA, me seli të regjistruar në Vaduz, në rr. LEGAZON TREUHAND, ANSTALT, Landstrasse 99, 9494 Schaan, Principata e Lihtenshtajnit, dhe Rockaway Media a.s. me seli të regjistruar në adresën Generála Píky 430/26, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Georgi Dimitrov Avokatë Shkup, në seancën e mbajtur më datë 18.03.2026, solli këtë:

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin FONDACIONI VALEA, me seli të regjistruar në Vaduz, në rr. LEGAZON TREUHAND, ANSTALT, Landstrasse 99, 9494 Schaan, Principata e Lihtenshtajnit, dhe Rockaway Media a.s., me seli të regjistruar në adresën Generála Píky 430/26, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Rockaway Arts a.s. me seli të regjistruar në adresën Generála Píky 430/26, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin e përqendrimit në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksat administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pageses 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 24.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e FONDACIONIT VALEA me seli të regjistruar në Vaduz, Principata e Lihtenshtajnit, dhe Rockaway Media a.s. me seli të regjistruar në Pragë, Republika Çeke, me të cilin FONDACIONI VALEA dhe Rockaway Media a.s., do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Rockaway Arts a.s. me seli të regjistruar në adresën Generála Píky 430/26, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, përmes shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në njoftimin për përqendrim dhe shtojcave bashkëngjitur tij, vërtetoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

FONDACIONI VALEA është një fondacion privat, i themeluar dhe i organizuar sipas ligjeve të Principatës së Lihtenshtajnit. Ai nuk ka aktivitete të veta afariste. Veprimtaria e tij kryesore është zotërimi (indirekt) i një pjese të vetme kontrolluese në KKCG (KKCG), me seli të regjistruar në adresën Kapellgasse 21, Lucern, Zvicër, e cila përfaqëson shoqërinë mëmë përfundimtare të Grupit KKCG (*KKCG Group*).

Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikën, patundshmëritë dhe teknologjinë e informacionit.

Përveç pjesëve në Grupin KKCG, FONDACIONI VALEA gjithashtu zotëron pjesë kontrolluese në disa subjekte të tjera („Shoqëritë VALEA“).

Asnjëra nga Shoqëritë VALEA nuk është e pranishme në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e menaxhimit të terminaleve të video-lotarive dhe në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ka këto shoqëri të varura:

- Casinos Austria International Makedonija SHPK, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup dhe me veprimtari kryesore – aktivitete të lojërave të fatit;
- Lotaria Shtetërore e Videove e Republikës së Maqedonisë – Casinos Austria SHPK Shkup, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup dhe me veprimtari kryesore – aktivitete të lojërave të fatit;
- AVENGA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. 11 Tetori nr. 33A Shkup dhe me veprimtari kryesore – programim kompjuterik;
- AVENGA ACADEMY SHPKNJP Shkup, me seli në rr. 11 Tetori nr. 33A Shkup dhe me veprimtari kryesore – arsim tjetër, i papërmendur diku tjetër në klasifikim;
- MUSALA SOFT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. 11 Tetori nr. 33A Shkup, me veprimtari kryesore – programim kompjuterik.

Rockaway Media a.s., është pjesë e Grupit JH. Aktivitetet e Grupit JH kryesisht kanë të bëjnë me e-tregtinë, teknologjitë financiare, mediat dhe botimin e librave, investimet në kapitalin e rrezikut, investimet në zhvillimin e patundshmërive, pajisjet teknike në fushën e mbrojtjes, si dhe blockchain dhe krypto-aktivet.

Grupi JH është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes Gjirafa Group, mbi të cilin ushtron kontroll të përbashkët.

Gjirafa Group menaxhon një motor kërkimi në gjuhën shqipe, një platformë për përmbajtje video dhe informative, një platformë marketingu online, një treg online për blerjen e makinave dhe një platformë për tregti elektronike të fokusuar në Shqipëri, Kosovë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi JH është i pranishëm përmes shoqërisë Shoqëria për tregti elektronike dhe shërbime GJIRAFI SHPKNJP Shkup. Me seli në Magjistralen e Adriatikut nr. 86 Shkup dhe me veprimtari - tregti me pakicë e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Rockaway Arts a.s. është një shoqëri holding që zotëron pjesë kontrolluese në subjekte aktive ekskluzivisht në Republikën Çeke dhe e fokusuar në segmentin kulturor dhe artistik.

Rockaway Arts a.s. nuk ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në asnjë mënyrë nuk është aktive në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ